

Emri i Lëndës : Mjekësia Ligjore							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 522	C	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	4.00
Lektori	Denard Veshi, Prof. Asoc. Dr.						
Asistenti	Surja Shehi, Msc						
Gjuha e kursit	Shqip						
Niveli i lëndës	Program i Integruar						
Përshkrimi	Mjekësia ligjore është lënda mësimore e cila e studion njeriun në raportet e tij me të drejtën. Ajo merret me studimin, përpunimin dhe zgjidhjen e çështjeve me karakter mjekësor e biologjik që hasen në praktikën hetimore e gjyqësore. Analiza e përcaktime të hollësishme bëhen për objektin e ekspertimit mjekoligjor, procesin e vdekjes dhe ndryshimet që i ndodhin trupit pas vdekjes, mënyren e zhvillimit të ekspertimit mjekoligjor të kufomës duke përfshirë këqyrjen, autopsinë, zhvarrimin, të dhëna të përgjithshme në lidhje me traumatologjinë dhe traumat komplekse, asfiksionet mekanike, toksikologjinë mjekoligjore, ekspertimin mjekoligjor në rastet e krimeve seksuale, identifikimin e provave materiale dhe të individëve si dhe veprat penale kundër shëndetit dhe përgjegjësinë ligjore të personelit shëndetësor në këto raste. Programi për leksione të caktuara parashikon seminare teoriko-praktike, në të cilat diskutohen temat me të prekura në fushën e ekspertimit mjekoligjor.						
Objektivat	1. Përvetësimi i njohurive bazë në fushën e mjekësisë ligjore dhe kriminalistikës; 2. Klasifikimi i dëmtimeve trupore në bazë të mjeteve apo mekanizmit të shkakut të tyre; 3. Të njohë konceptet themelore dhe të bëjë dallimin midis dëmtimeve gjatë jetës dhe pas vdekjes; 4. Zbulimi, Fiksimi, Marrja dhe ekzaminimi i gjurmëve me natyrë biologjike; 5. Zbulimi, Fiksimi, Marrja dhe ekzaminimi i gjurmëve traseologjike; 6. Kategorizimi juridik i dëmtimeve trupore.						
Konceptet Kryesore	1. Fenomenet kufomore 2. Ekspertimi i kufomës dhe këqyrja e vendit të ngjarjes 3. Dëmtimet mekanike 4. Gjurmët me natyrë biologjike 5. Gjurmët traseologjike 6. Dëmtimet nga armët e zjarrit 7. Hetimi kriminalistik						
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Në këtë temë do të trajtohet Mjekësia ligjore kriminalistike, përkufizimi, përmbajtja dhe objektet e ekspertimit. Mjekësia ligjore kriminalistike merret me studimin dhe përpunimin e çështjeve me karakter biologjik në praktien hetimore dhe gjyqësore. Objektet e ekspertimit mjekoligjor janë ekspertimet e kufomave, personave, provave materiale dhe ekspertimet në bazë të materialeve të çështjes; (Fq.20-28)						
2	Në këtë temë do të trajtohet Tanatologjia, vdekja dhe ndryshimet pas vdekjes. Kriteret e përcaktimit të vdekjes janë provat negative të jetës dhe provat pozitive të vdekjes ose dukuritë kufomore. Këto të fundit ndahen në dukuri kufomore të hershme dhe të vonshme; (Fq.29-62)						
3	Në këtë temë do të trajtohet Traumatologjia, Dëmtimet mekanike nga faktorë të jashtëm. Ato klasifikohen sipas llojeve të dëmtimeve dhe lokalizimit në trup dhe mjeteve shkaktoese të tyre; (Fq.108-143)						
4	Në këtë temë do të trajtohen Traumatologjia, Dëmtimet mekanike nga faktorë të jashtëm. Kategorizimi juridik i dëmtimeve trupore; (Fq.143-169)						
5	Në këtë temë do të trajtohen Gjurmët me natyrë Biologjike. Mekanizmi i formimit të gjurmëve me natyrë biologjike dhe klasifikimi i tyre. Rregullat e përgjithshme të zbulimit, të fiksimit dhe të marrjes së gjurmëve me natyrë biologjike. (Fq.382-396)						

6	Në këtë temë do të trajtohet Gjurmët me natyrë Traseologjike. Mekanizmi i formimit të gjurmëve traseologjike dhe klasifikimi i tyre. Rregullat e përgjithshme të zbulimit, të fiksimit dhe të marrjes së gjurmëve traseologjike. (Fq.113-190 Kriminalistika)	
7	Në këtë temë do të trajtohen Raste studimore;	
8	Provimi gjysmëfinal	
9	Në këtë temë do të trajtohet Dëmtimet nga armët e zjarrit. Janë dëmtime të ngjashme me plagët mbretëse dhe shpuese, njëkohësisht edhe me karakteristika të veçanta të shkaktuara nga lloje të ndryshme të armëve të zjarrit. Bëhet përcaktimi i drejtimit të qitjes, distancës së qitjes dhe llojit të armës; (Fq.191-219)	
10	Në këtë temë do të trajtohet taktika e Këqyrjes së Vendit të Ngjarjes: Kuptimi dhe detyrat e këqyrjes së vendit të ngjarjes. Përgatitja për keqyrjen e vendit të ngjarjes. Metodat taktike të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Ngritja dhe verifikimi i versioneve hetimore në këqyrjen e vendit të ngjarjes. Mjetet teknike kriminalistike për fiksimin e rezultateve. (Fq.336-367 Kriminalistika)	
11	Në këtë temë do të trajtohet Ekspertimi mjekoligjor i kufomës. Nga pikëpamja mjekoligjore vdekjet klasifikohen në vdekje natyrale, vdekje me dhunë dhe vdekje aksidentale. Ekzaminimi kryhet në disa faza: Këqyrja e kufomës në vendin e ngjarjes, Autopsia mjekoligjore dhe Zhvarrimi i kufomes; (Fq.63-100)	
12	Në këtë temë do të trajtohet Simulimet. Format e simulimeve Mjeko Ligjore dhe vetëdëmtimet; (Fq.352-356)	
13	Në këtë temë do të trajtohet Shkeljet Mjekësore. Llojet e shkeljeve mjekësore dhe ekspertimi mjeko ligjor i tyre; (Fq.257-366)	
14	Në këtë temë do të trajtohet Toksikologjia mjekoligjore. Studiohen dëmtimet që i vijnë shëndetit dhe vdekjet nga helmimet e ndryshme. Format mjekoligjore sipas shpeshtësisë janë helmimet aksidentale, vetëvrasjet dhe shumë rrallë vrasjet. (Fq.292-309)	
15	Në këtë temë do të trajtohen Raste studimore;	
16	Provim Final	
Parakushtet		Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura		• - Spiro Cipi, Bardhyl Cipi, Ilirjan Mandro dhe Sokrat Meksi. Mjekësia Ligjore Kriminalistike. Tiranë 2020 • - Mandro, Ilirjan. Kriminalistika. Tiranë 2022
Referenca të tjera		• - Begeja, Skënder. Kriminalistika. Tiranë 2004 • - Sokrat Meksi dhe Arben Lloja, • - Sokrat Meksi, Gramos Ylli dhe Bledar Xhemali, • - Bashkim Cuberi, Sokrat Meksi dhe Bardhyl Cipi, • - Sokrat Meksi dhe Flamur Blakaj
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat		
1	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe njohin fenomenet e ndryshme kufomore;	
2	Studentët do të jenë të aftë të identifikojnë shenjat grupore dhe shenjat e veçanta të identifikimit mjekoligjor;	
3	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe zbatojnë ekspertimin e kufomës;	
4	Studentët do të jenë të aftë të zbulojnë, fiksojnë dhe ekzaminojnë gjurmët me natyrë biologjike;	
5	Studentët do të jenë të aftë të klasifikojnë llojet e ndryshme të dëmtimeve sipas lokalizimit;	
6	Studentët do të jenë të aftë të klasifikojnë llojet e ndryshme të dëmtimeve sipas mjeteve shkaktuese të tyre;	
7	Studentët do të jenë të aftë të bëjnë kategorizimin juridik të dëmtimeve trupore;	

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	20	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			100
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.00
ECTS			4.00